

# Fitimi i shtetësisë me origjinë

## Përshkrimi

Fitimi i shtetësisë me dhënie të shtetësisë për persona me origjinë shqiptare.

## Dokumentacioni i nevojshëm

- 1) Kërkesa e shtetasit të huaj drejtuar Presidentit të Republikës;
- 2) Formulari i kërkesës për dhënien e shtetësisë për personin me origjinë shqiptare (Formulari B);
- 3) Fotokopje të dokumentit të identifikimit;
- 4) Certifikatë lindje;
- 5) Certifikatë familjare;
- 6) Dëshmi penaliteti e legalizuar ose pajisur me vulë apostillë dhe të përkthyer;
- 7) Dokumentacioni mbështetës që vërteton se është pasardhës në vijë të drejtë nga një shtetas shqiptar (deri në tre shkallë) dhe se i paralinduri dhe aplikuesi nuk kanë hequr dorë nga zotërimi i shtetësisë shqiptare,
- 8) Relacion shpjegues mbi interesin kombëtar që paraqet kërkesa;
- 9) Mandat pagesa.

## Hapat e procedurës

- 1) Paraqitja e dokumentacionit me postë ose personalisht;
- 2) Verifikimi i dokumentacionit nga konsulli;
- 3) Përcjellja e dokumentacionit zyrtarisht nga përfaqësia për autoritetet përgjegjëse.

## Tarifa e shërbimit dhe afati

30 euro

Në varësi të rregullshmërisë së praktikës, 3 muaj

## Zyra

Të gjitha përfaqësitë diplomatike dhe konsullore

## Shënime

Aplikimet për dhënien e shtetësisë shqiptare janë individuale, veç atyre të shtetasve të mitur, për të cilët shprehen prindërit e tyre. Nuk mund të aplikojnë shtetas të Republikës së Kosovës. Aplikimet për fitimin e shtetësisë me natyralizim dorëzohen vetëm pranë Komisariateve të Policisë në Shqipëri. Të gjitha dokumentet (të prodhuara në Shqipëri apo në vende të tjera pranohen kur janë në harmoni të plotë me njëri tjetrin, pa gabime e korrigjime.

Të gjitha dokumentet për heqje dorë nga shtetësia sigurohen nga vetë të interesuarit.

Pagesa e tarifës së shërbimit konsullor kryhet nëpërmjet bankës

## Formularë të nevojshëm:

Formulari i kërkesës për dhënien e shtetësisë shqiptare për personin me origjinë shqiptare

Formulari B